# DËSHMI ARKIVI

**A-457933**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Alarm në Zvicër për Granit Xhakën, prokuroria hap hetim për certifikatat e COVID-it |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/19/alarm-ne-zvicer-per-granit-xhaken-prokuroria-hap-hetim-per-certifikatat-e-covid-it/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 14:03:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 19 shtator 2026, 13:58:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën **text_date**. Dritarja: 19 shtator 2026, 13:57:00 UTC → 19 shtator 2026, 13:59:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6e9b200933bc3427e29746b7059c774ad9d80d3d30b2960980e407e265e5369c` |
| TEKSTI | `2037926f99d3f1668a99007c5ef9e7ac2187d3e7665460814f2b8a343d306a64` |
| PAMJA | `7ac536989135c48cc75fd468fd8a19809c8d2dc20c7a84fbc56ba6c962f4700c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3883fb059e35cf813395b6714b7cb517b0e236b14062e0da2eb04e3831a9de08` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a624a8de2af3663fb45f82c1ddada674f965fa5760c0cdbc3d58cf8121d973c9` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3883fb059e35cf813395b6714b7cb517b0e236b14062e0da2eb04e3831a9de08`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Alarm në Zvicër për Granit Xhakën, prokuroria hap hetim për certifikatat e COVID-it

19/09/2026 15:58




**Granit Xhaka është vënë nën hetim nga autoritetet zvicerane për dyshime lidhur me certifikata të falsifikuara të COVID-19. Kapiteni i kombëtares së Zvicrës pritet të merret në pyetje nga Prokuroria Publike e kantonit të Lucernës në fillim të muajit tetor.**

Sipas informacioneve të publikuara nga "Blick", hetimi lidhet me certifikata vaksinimi që dyshohet se janë lëshuar nga një mjeke në Lucernë. Zyra e saj ishte kontrolluar nga policia në vitin 2023, ndërsa gjatë operacionit ishin sekuestruar prova. Sipas hetuesve, disa pacientë dyshohet se kishin marrë certifikata të falsifikuara prej saj.

Zëdhënësi i Prokurorisë Publike të Lucernës, Simon Kopp, konfirmoi për "Blick" se ndaj Xhakës dhe mjekes janë hapur procedura penale.

"Qëllimi është të përcaktohet nëse janë kryer vepra penale në lidhje me marrjen e mundshme mashtruese të një certifikate të rreme dhe/ose falsifikimin e dokumenteve", deklaroi Kopp.

Çështja lidhet me historinë e vaksinimit të Xhakës gjatë pandemisë. Më 1 shtator 2021, futbollisti rezultoi pozitiv me koronavirus. Në atë moment, ai nuk ishte vaksinuar dhe nuk kishte kaluar më parë COVID-19. Infektimi e detyroi të mungonte në një ndeshje miqësore të Zvicrës ndaj Greqisë, si dhe në një tjetër takim.

Më vonë, Xhaka deklaroi publikisht se ishte vaksinuar kundër COVID-19. Pikërisht kjo është një nga çështjet që po hetohet tani nga autoritetet zvicerane: nëse vaksinimet kanë ndodhur realisht apo nëse për të është lëshuar vetëm një certifikatë. Megjithatë, mbrojtja e futbollistit mohon se dokumentet janë të falsifikuara.

Zëdhënësi i Xhakës, Andreas Bantel, deklaroi se kapiteni i Zvicrës është i gatshëm të bashkëpunojë plotësisht me autoritetet.

"Granit Xhaka është plotësisht në dispozicion të autoriteteve dhe po bashkëpunon në mënyrë transparente", tha Bantel.

Ai shtoi se Xhaka disponon një certifikatë nga mjeku që e ka trajtuar, sipas së cilës futbollisti është vaksinuar kundër COVID-19 më 25 janar 2022 dhe më 11 nëntor 2022.

"Granit Xhaka ka një certifikatë nga mjeku që e trajtoi, e cila konfirmon se është vaksinuar kundër COVID-19 për herë të parë më 25 janar 2022 dhe për herë të dytë më 11 nëntor 2022", sqaroi Bantel.

Edhe mjekja e përfshirë në hetim mohon çdo shkelje. Avokati i saj, Cornel Borbely, tha për "Blick" se klientja e tij këmbëngul se e ka vaksinuar personalisht Xhakën dhe se procedura është kryer në përputhje me rregullat.

Federata Zvicerane e Futbollit, ndërkohë, është shprehur e rezervuar. "Në këtë fazë, nuk

## SPORT • KRYESORE



Kush janë surprizat e Maranit? Një rikthim i madh, dy debutues dhe disa mungesa të bujshme




"Lojtarët e Superiores do e kenë shansin në të ardhmen"/ Maran: Pse mungojnë të rinjtë? Jemi pak të limituar, objektiv kemi vendin e parë



"Unë flas në fushë"/ Harry Kane i përgjigjet deklaratave të forta të Yamal: Nuk e di çfarë qëllimi kishte pas asaj që tha, por...




Sandro Mazzola, një jetë me Interin: Nga legjenda e "San Siros" te drejtuesi që solli në klub yje si Ronaldo

## ME TË LEXUARAT

"Je e bukur, do të vish në hotelin tim?"/ Modelja kolumbiane publikon bisedën me futbollistin e njohur

Lista e Kombëtares/ Trajneri Maran lë jashtë Brojën dhe Bajramin, rikthehet Etrit Berisha. Thirren edhe dy debutues

Historia përsëritet në Itali, nga Baresi e Inzaghi te vëllezërit Esposito

Nga kampion Europe te "ndërtimi nga e para", Mancini zbulon planin

kemi informacion të besueshëm për këtë çështje dhe për këtë arsye nuk mund të komentojmë", deklaroi ASF.

Për momentin, si Granit Xhaka, ashtu edhe mjekja që dyshohet se ka lëshuar certifikatat, konsiderohen të pafajshëm. Hetimi do të duhet të përcaktojë nëse ka pasur shkelje penale dhe nëse dokumentet e vaksinimit të futbollistit janë të rregullta.

**Rasti Xhaka nuk është i vetmi**

Në Zvicër ka pasur edhe raste të tjera që kanë përfshirë certifikata të dyshuara të falsifikuara të COVID-19.

Shoku i Xhakës te kombëtarja, Breel Embolo, u përmend në një çështje të tillë që u bë publike pas një procesi gjyqësor në Bazel në maj të vitit 2024. Në atë rast, bëhej fjalë për dy certifikata testimi për udhëtime, të lëshuara në emër të futbollistit nga një person që punonte në një laborator.

Një tjetër rast që shkaktoi reagime të forta në Zvicër ishte ai i Patrick Fischer, trajnerit të kombëtares zvicerane të hokejit në akull. U zbulua se Fischer nuk ishte vaksinuar kundër COVID-19 dhe se kishte udhëtuar në Lojërat Olimpike Dimërore të vitit 2022 me një certifikatë të falsifikuar. Edhe ai ka folur më vonë publikisht për çështjen.

Në rastin e Xhakës, megjithatë, hetimi është ende në zhvillim dhe nuk ka një vendim gjyqësor që të përcaktojë përgjegjësi penale.

**Top Channel**

## Futboll »



Xabi Alonso në vorbullën e kritikave: Chelsea nuk nënshkroi me të për të pësuar humbje si ajo me Brentford

19/09 14:33



Premier League, një trajner nuk e donte Cristiano Ronaldo nën urdhrat e tij, ja për cilin bëhet fjalë

19/09 13:58



Trajneri Maran e la jashtë listës, Jasir Asani nuk e fsheh pakënaqësinë: Historia nuk harrohet kurrë

19/09 13:35



Derbi i Madridit, Real-Atletico/ Simeone dhe Mourinho, dy kolosë që vihen sërish përballë pas 12 vitesh

19/09 13:14



FSHF refuzon kërkesën e Tiranës, ndeshja ndaj Elbasanit do të luhet pa tifozë në stadium

19/09 12:58



Bayerni 'e shpartalloi' 7-0, Union Berlin 'fajëson' Yamal: Nuk mund të rrinte pa folur...?

19/09 12:31

## Kryesore »



Sulm kibernetik para zgjedhjeve në Rusi? Hakerët pretendojnë qasje në sistemet zgjedhore

19/09 16:00




Perspektivë pozitive e Shqipërisë/ Moody's mban vlerësimin 'Ba3', sheh rritje 3.6% të ekonomisë dhe ulje graduale të borxhit

19/09 15:24



Më 8 tetor miratohet harta e re territoriale/ Votat në favor të mazhorancës, PD kundër

19/09 15:21







për Italinë

"Kerjota ka spikatur, mund të na ndihmojë", Maran flet për listën e Kombëtares: Ja pse nuk i ftova Brojën dhe Bajramin, dera mbetet e hapur

Ndahet nga jeta Sandro Mazzola, ikona e Interit dhe legjenda e futbollit italian

Bayerni 'e shpartalloi' 7-0, Union Berlin 'fajëson' Yamal: Nuk mund të rrinte pa folur...?

Kush janë surprizat e Maranit? Një rikthim i madh, dy debutues dhe disa mungesa të bujshme

Gruda, Adri Mehmeti dhe Kurtulan?/ Trajneri i Kombëtares: Lojtarët e dinë që i duam te Shqipëria, por zgjedhja mbetet në dorën e tyre

"Dua Real Madridin në Champions"/ Intervista e Lamine Yamal: Si e bërtitura e Busquets më ndryshoi jetën, pika jona e dobët janë Bayern dhe PSG



Amnistia ngec nëpër sirtarë/ Prokuroria vonon zbritjen e dënimit për 2868 persona në Shërbimin e Provës

19/09 15:05



Tri viktima identifikohen pas 27 vitesh nga zhdukja, Kurti: ADN-ja konfirmoi lidhjen me "Grupin e Intelektualëve"

19/09 14:53



Zjarr në një banesë në Bulqizë, shpëtohet një person me aftësi të kufizuara

19/09 14:22

## Sport »



"Duhet të përmirësohemi"/ Amorim kërkon reagim pas humbjes me Benficën: Me Leccen vetëm për fitore

19/09 15:12



Xabi Alonso në vorbullën e kritikave: Chelsea nuk nënshkroi me të për të pësuar humbje si ajo me Brentford

19/09 14:33



"Je e bukur, do të vish në hotelin tim?"/ Modelja kolumbiane publikon bisedën me futbollistin e njohur

19/09 14:18



Premier League, një trajner nuk e donte Cristiano Ronaldo nën urdhrat e tij, ja për cilin bëhet fjalë

19/09 13:58



Trajneri Maran e la jashtë listës, Jasir Asani nuk e fsheh pakënaqësinë: Historia nuk harrohet kurrë

19/09 13:35



Derbi i Madridit, Real-Atletico/ Simeone dhe Mourinho, dy kolosë që vihen sërish përballë pas 12 vitesh

19/09 13:14

## Sport - Kosova »



Eksodi te Kosova vazhdon, dy lojtarë të tjerë i japin fund aventurës me përfaqësuesen dardane pas Rrahmanit dhe Hadërgjonajt

18/09 16:06



'Nuk ekziston më respekti dhe besimi'/ Kosova në kaos, Hadërgjonaj vendos të mos luajë me Dardanët nën drejtimin e Fodës

17/09 20:24



'JO NË EMRIN TIM!', Taulant Xhaka shpërthen pas Hagës, reagimi i tij tërbon mediat serbe

17/09 19:08



'Më informoi personalisht për vendimin e marrë, s'është e vërtetë se...'/ Trajneri Foda thyen heshtjen për tërheqjen e Rrahmanit nga kombëtarja e Kosovës

17/09 17:02



Skandali apo rregulli i hekurt? Pse Kosova po luan me "zjarrin" duke lënë jashtë dy më të mirët e Serie A

15/09 14:58



Zhegrova shkëlqen me dy gola, por as kjo nuk e kënaq Spallettin: I pandalshëm një kundër një, por nuk kthehet kur humb topin

14/09 12:06

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »








Top News – Berisha pro hapjes së muzet hebraik në Vlorë: PD mbështet tolerancën fetare

Top News – “Rama loboi për mua”/ Berisha: Unë nuk bëj njësoj, nuk do ndërhyjë për...

Top Channel/ SHBA-Kinë “në prag lufte”? “Drejt konfliktit ushtarak nga një raport i rremë i AI”!

Top News -Debati për pagat e gjyqtarëve/ Berisha akuza Begajt: Kukull e Ramës, dekretoi ligjin natën

Top Channel/ Historia shqiptare përmes AI! Xhulio Vasiu kthen traditat në filma vizatimorë

Top Channel/ U tallën me Çerçizin! Ikën nga detyra kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.